

RAPORT
nga debati publik për Projektligjin
për kontrollin e emetimeve industriale

Më 20 tetor 2022 në hotelin “BUSHI RESORT & SPA” në Shkup, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH) mbajti debat publik për Projektligjin për kontrollin e emetimeve industriale.

Në debatin publik morën pjesë 28 përfaqësues nga industria, kompanitë e njohura, organizatat e shoqërisë civile, shërbimet inspektuese dhe institucionet tjera (SHA Makstil, SHA Çimentorja Shkup, Eko Vetëdija, Oda Ekonomike, ISHMJ, përfaqësues nga sektori i mjedisit jetësor i komunës së Velesit.).

Organizator i debatit publik për Projektligjin për kontrollin e emetimeve industriale ishte MMJPH. Debatin publik e hapi dhe e udhëhoqi moderatorja Biljana Tesheva Gjorgievska, udhëheqëse e Departamentit për Çështje Juridike dhe të Përgjithshme në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Ajo dha një pasqyrë të shkurtër se Ligji për Kontrollin e emetimeve industriale është zhvilluar me ndihmën e BE-së përmes projektit të binjakëzimit MK11/IB/EN/01/R “Forcimi i kapaciteteve administrative në nivel qendror dhe lokal për transpozimin dhe zbatimin të Direktivës së re për emetimet industriale 2010/75/BE” dhe bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet Departamentit për Çështjet Ligjore dhe të Përgjithshme dhe Departamentit për Ndotjen Industriale, Administrimin e Mjedisit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Jetësor, që përfaqëson afrimin e legjislacionit kombëtar me atë evropian për shkak të nevojës për të siguruar kushte për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes së shkaktuar nga aktivitetet industriale, si dhe në sigurimin e kushteve për parandalimin, ose nëse kjo është e pamundur, reduktimin e emetimeve në ajër, ujë dhe tokë dhe parandalimin e gjenerimit të mbetjeve.

U përmend se në periudhën e kaluar MMJPH ka hapur një proces konsultimi për projektligjin, si dhe janë mbajtur disa takime pune me disa nga palët e interesuara (OJQ-të Eko Vetëdija dhe Florozon dhe përfaqësues nga Fakulteti Metalurgjik Teknologjik).

Ligji është postuar në portalin Ener dhe në faqen e MMJPH-së.

Për ligjin kemi marrë komente nga Makstil dhe Oda ekonomike.

Komentet janë pranuar pjesërisht dhe brenda afatit të përcaktuar ligjor, përgjigja është postuar në portalin Ener.

Më pas, fjalim mbajti z. Naser Nuredini ministër i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejshëm: ministër).

Ai theksoi se miratimi i Ligjit për kontrollin e emetimeve industriale mundëson parandalimin dhe sa më shumë që të jetë e mundur zvogëlimin e ndotjes që shkaktohet ose mund të shkaktohet nga zbatimi i aktivitetëve industriale, përmes kontrollit të aktivitetëve industriale në përputhje

me dispozitat e ligjit, si dhe sigurimin e një qasjeje të integruar të përshtatshme për parandalimin dhe kontrollin e emetimeve në ajër, ujë dhe tokë.

Besa Tateshi, udhëheqëse e Departamentit për Parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes PKIN, Drejtorja e mjedisit jetësor, organ në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, prezantoi risitë në Projektligjin për Kontrollin e emetimeve industriale përmes një analize krahasuese të ndryshimeve dhe plotësimeve të reja që mbulohen nga Projektligji dhe dispozitat e ligjit të përhershëm, duke vënë në dukje se Projektligji transponon plotësisht dhe në mënyrë efektive Direktivën e Emisioneve Industriale 2010/75/BE dhe përcakton parimet bazë për dhënien e lejeve dhe kontrollin e instalimeve industriale, bazuar në një qasje të integruar dhe zbatim të detyrueshëm të konkluzioneve mbi teknikat më të mira të disponueshme, në lidhje me objektet e mëdha industriale që i nënshtrohen lejeve të integruara A.

Ligji mundëson një rregullim më të detajuar të kushteve të përcaktuara në leje, dhe ajo që është veçanërisht e rëndësishme për objektet më të vogla që i nënshtrohen lejeve të integruara - B vendosen rregulla sektoriale, të përgjithshme dhe detyruese, që do të jetë ndihmesë e madhe për komunitat.

Besa Tateshi theksoi se ligji i ri për kontrollin e emetimeve industriale do të sjellë përfitime të mëdha për një mjedis më të pastër, zbatimin e Direktivës së emisioneve industriale do të sjellë cilësi më të mirë të ajrit (përsa i përket emetimeve të pluhurit, SO₂, NO_x, metaleve dhe dioksinave), do të përmirësohet cilësia e ujit dhe tokës, do të mundësohet një menaxhim më i mirë i mbetjeve dhe energjisë, do të reduktohen dëmtimet e bimësisë dhe ekosistemeve, por do të ketë edhe efekte pozitive në ekonomi.

Përmbajtja e prezantimit përfshinte: kornizën aktuale ligjore, Direktivën e emetimeve industriale 2010/75/BE, Ligjin për Kontrollin e emetimeve industriale, Konkluzion, aktivitete të realizuara dhe të ardhshme.

Kuadri ligjor aktual përfshin kuadrin ligjor për PKIN, i cili përbëhet nga Ligji i mjedisit jetësor (Kapitulli XII & XIV), LMM, LCAA, LA, aktet përkatëse nënligjore, si dhe sistemi i integruar maqedonas për dhënien e lejeve llojin e lejeve - sipas për kapacitetet dhe veprimtarinë industriale: A – Leje e Integruar Mjedisore (organi kompetent: MMJPH) dhe B – Leje e Integruar Mjedisore (organi kompetent: Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale, me përjashtim të zonave të mbrojtura).

Dispozitat e Direktivës së BE-së për Emetimet Industriale - , DEI 2010/75/EU kombinojnë direktivat e mëposhtme të pavarura më parë: Direktiva PKIN 2008/1/EC (LMJ, Kap. XII & XIV), Direktiva IMD 2001/80/ECGHG dhe Rregullorja mbi GS në ajër nga burime të palëvizshme, Direktiva për djegien e mbetjeve 2000/76/EC (mbeturinat), Direktiva për emetimet e OIS nga tretësit 199/13/EC (LCAA, Rregullorja për VKE në ajër nga burimet stacionare), 3 Direktiva të lidhura me industrinë TiO₂ 78/176/EC, 82/883/EC dhe 92/112/EC (transpozuar rishtazi), Transpozuar ~ 60%.

Nga Besa Tateshi, u prezantuan kapitujt në vijim të Projektligjit për Kontrollin e emetimeve industriale: Kapitujt I – III → Dispozitat e përbashkëta, Kapitulli IV – Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes, Kreu V – Dispozita të veçanta për Impiantet e mëdha me djegie, Kapitulli VI – Dispozita të veçanta për instalimet për djegien dhe bashkë-djegien e mbetjeve, Kapitulli VII – Dispozita të veçanta për instalimet dhe aktivitetet që përdorin tretës organikë, Kapitulli VIII – Dispozita të veçanta për instalimet nga industria TiO₂, Kapitulli IX – IED në nivel lokal (B-IED), Kapitujt X – XII → Mbikëqyrja, sanksionet penale dhe dispozitat kalimtare.

Në debatin publik për këtë projektligj u dëgjuan komente dhe sugjerime konstruktive nga përfaqësuesit e pranishëm.

Në kuadër të diskutimit fillimisht foli përfaqësuesi i kompanisë SHA Makstil, i cili mbështeti Projektligjin për Kontrollin e Emetimeve Industriale, i cili gjithashtu iu drejtoi pyetje ekspertëve të pranishëm në debatin publik lidhur me lejen e integruar mjedisore – A që duhet ta posedojë operatori, konkretisht nëse përveç Lejes që operatori i instalimit duhet të posedojë, është e nevojshme të posedojë edhe një Elaborat. Përfaqësuesi mori përgjigje eksperte në pyetjen se i njëjti është përfshirë me procedurën A dhe E, që është në kompetencë të Sektorit të Mjedisit Jetësor.

I njëjti përfaqësues bëri pyetje në lidhje me TMD, cilat janë TMD-të në cilin dokument janë përfshirë, për të cilën mori një përgjigje të duhur nga eksperti se procesi i Seviljes prodhon konkluzionet BAT dhe në përputhje me këtë secila industri ka konkluzionet e saj BAT.

Përfaqësuesi i Çimentoresh Usje SHA Shkup shprehu qëndrim pozitiv në lidhje me ndryshimet dhe plotësimet e reja të përfshira në dispozitat ligjore të përfshira në Projektligjin për kontrollin e emetimeve industriale, me propozime dhe komente të dorëzuara shtesë për Projektligjin për kontrollin e emetimeve industriale, të publikuara në faqen e internetit të Regjistrimit të Vetëm Kombëtar Elektronik të Rregulloreve (ENER), pas konsultimit dhe shqyrtimit të draft zgjidhjes ligjore të publikuar nga kompanitë anëtare, përmes Odës Ekonomike të Maqedonisë së Veriut.

Përfaqësuesi Çimentoresh Usje SHA Shkup, pas marrjes së përgjigjes, ka bërë vërejtje lidhur me distancën, largësinë e aktivitetit brenda fabrikës në më pak se 5 km, duke sqaruar dispozitën. Përgjigja profesionale që ka vijuar në bazë të vërejtjes është se dispozita ligjore është marrë parasysh në procedurën A dhe E të përfshira në Ligjin për mjedisin jeterësor, me atë rast nuk merret parasysh teknika IPPS.

Gjatë diskutimit, përfaqësuesi i SHA Makstil në pyetjen e tij në lidhje me afatin e parashikuar ligjor prej një viti për harmonizimin e konkluzioneve BAT kur ato të miratohen në nivel shtetëror, nga eksperti mori sqarim se brenda afatit të parashikuar ligjor prej një viti, operatori i instalimit është i detyruar t'i dorëzojë Raport organit kompetent.

Përfaqësuesi nga shoqata ekologjike "Ekosvest" kishte vërejtje rreth ndryshimit të rëndësishëm, për të cilin mendon se në atë rast duhet të inicohet një procedurë e re në lidhje me të cilën duhet të informohet edhe publiku, duke pasur parasysh se ndikon në mjedis.

Nga i njëjti përfaqësues pasoi një shënim në lidhje me dispozitën ligjore të nenit 30 pikës 6 të Ligjit për Kontrollin e Emetimeve Industriale, me kërkesë për specifikimin e afatit kohor, në lidhje me të cilin u sugjerua që shoqata ekologjike t'i dorëzojë komentet në formë të shkruar në bazë të projektzgjdhjes ligjore në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, në bazë të të cilit shoqatës ekologjike do t'i dorëzohet një shpjegim me shkrim.

Në fjalimin përfundimtar të ministrit drejtuar përfaqësuesve të pranishëm në debatin publik, u theksua se komentet dhe vërejtjet mund t'i dorëzohen Ministrisë në dhjetë ditët e ardhshme, se ato janë të mirëseardhura dhe do të shqyrtohen dhe do të përgjigjen në përputhje me rrethanat, me qëllim që të merret një Ligj i mirë dhe i zbatueshëm që do të mundësojë zhvillimin e ekonomisë sipas standardeve evropiane, por edhe mbrojtje dhe kontroll më të madh të cilësisë së mjedisit.

Para skadimit të afatit ligjor për dorëzimin e komenteve nga Shoqatat për Prodhimin e Energjisë Elektrike dhe Termike TE-TO SHA SHKUP, kemi pranuar komente për Projektligjin për kontrollin e emetimeve industriale dhe bashkëngjitur më poshtë është rishikimi me përgjigjet tona për t'i vënë ato në dispozicion të publikut:

➤ **Neni nga Projektligji (i cituar) - Neni 4 Përkufizimet**

Paragrafi i nenit përkatës - 41. "Turbinë me gaz" është çdo makinë rrotulluese që e shndërron energjinë termike në punë mekanike, e përbërë kryesisht nga një kompresor, një pajisje termike në të cilën lënda djegëse oksidohet me qëllim që ta ngrohë lëngun e punës dhe turbinën, kjo i përfshin turbinat me gaz me cikël të hapur dhe të kombinuar dhe turbinat me gaz në të cilat regjimi ko-gjenerativ, të gjitha me ose pa djegie shtesë;

Koment - 41. "Turbinë me gaz" është çdo makinë rrotulluese që shndërron energjinë termike në punë mekanike, e përbërë kryesisht nga një kompresor, një pajisje termike në të cilën karburanti oksidohet me qëllim që të ngrohë lëngun fluid dhe turbinën. Kjo i përfshin edhe turbinat e gazit me cikël të hapur edhe të kombinuar si dhe turbinat me gaz në regjimin ko-gjenerativ, të gjitha me ose pa djegie shtesë;

Përgjigje nga MMJPH-ja - Vërejtja është e pranueshme.

➤ **Neni nga Projektligji (cituar) - Neni 29 (Dhënia e lejes së integruar ekologjike) dhe Neni 45 (Ndryshimi i A- lejes së integruar ekologjike sipas detyrës zyrtare)**

Paragrafi nga neni përkatës - (8) Kushtet në Lejet e Integruara Ekologjike i nënshtrohen rishikimit, çdo shtatë.

(10) Organi profesional është i detyruar që çdo shtatë vjet t'i kontrollojë rregullisht kushtet e përcaktuara në leje dhe nëse është e nevojshme, të fillojë procedurë për ndryshimin e lejes.

Koment - Cila është procedura në rastin e Rishikimit të Lejes veçanërisht nëse instalimi nuk ka ndryshim të rëndësishëm në teknologji?

Si duhet të zhvillohet komunikimi ndërmjet operatorit dhe organit kompetent, kur duhet të fillojë sa më parë?

Përgjigje nga MMJPH-ja: Procedura shpjegohet në nenet 44, 45, 46, 47 dhe 48.

- **Neni nga Projektligji (i cituar)** - Neni 32 Paraqitja e mendimeve lidhur me kërkesën

Paragrafi nga neni përkatës - (5) Me kërkesën të publikut të tanguar, operatori është i detyruar të organizojë një debat publik, më herët 15 ditë nga dita e publikimit të kërkesës së plotë, por jo më vonë se dhjetë ditë përpara skadimit të afatit të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni.

Koment - Në interes të shkurtimeve të periudhës së dhënies së lejes, mendojmë se konsultimi me publikun duhet të kufizohet vetëm një herë gjatë procedurës (kjo sidomos në rastin e rinovimit të lejes)

Përgjigje nga MMJPH-ja: Përgjigjia për këtë vërejtje gjendet në Nenin 32 paragrafin (5).

- **Neni nga Projektligji (i cituar)** - Neni 33 Afati për dhënien e Lejes së Integruar Ekologjike

Paragrafi nga neni përkatës - (1) Organi profesional është i obliguar që të sjellë vendim për dhënien e lejes për instalimin industrial përkthësisht impiantin në afat jo më të gjatë se 180 ditë nga përfundimi, si dhe të njëjtën ta publikojë në faqen e saj të internetit menjëherë pas miratimit së bashku me lejen e lëshuar.

Koment - Periudha prej 180 ditësh është shumë e gjatë, veçanërisht për rastet kur kërkohet rinovimi i lejes ekzistuese. Për raste të tilla sugjerojmë që afati të mos jetë më i gjatë se 90 ditë.

Përgjigje nga MMJPH-ja: Vërejtja nuk është e pranueshme. Në rast rinovimi (ndryshim i rëndësishëm), procedura duhet të vazhdojë sikur të jepet një leje e re.

- **Neni nga Projektligji (i cituar)** - Neni 35 Përmbajtja e A- lejes së integruar ekologjike

Paragrafi nga neni përkatës - (6) Drafti i A- lejes së integruar ekologjike i dorëzohet operatorit në mënyrë elektronike. Operatori mund t'i paraqesë vërejtjet e tij brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së draft-lejes.

Koment - Nuk është e specifikuar periudha (pas sa ditësh) i dorëzohet operatorit draft leja.

Përgjigje nga MMJPH-ja: Vërejtja nuk është e pranueshme. Nuk është e mundur që të përcaktohet një afat kohor për shkak të specifikës së Draft A-lejes së integruar ekologjike

- **Neni nga Projektligji (i cituar)** - Neni 42 Miratimi i Konkluzionit për teknikat më të mira në dispozicion.

Paragrafi nga neni përkatës – Në afat prej gjashtë muajve pas publikimit të Konkluzionit të ri për TMD (1) Ministri që e udhëheq organin shtetëror përgjegjës për çështjet nga fusha e mjedisit, me propozimin e organit ekspert, me vendime të veçanta i miraton konkluzionet për TMD të miratuara nga organet e Bashkimit Evropian.

Koment - Tani për tani, mendojmë se periudha gjashtëmuajore është shumë e shkurtër dhe është një detyrim tepër ambicioz për miratimin e konkluzioneve të TMD në nivel kombëtar. Afati do të ishte i pranueshëm nëse do të bëheshin anëtare të BE-së.

Përgjigje nga MMJPH-ja: Vërejtja nuk është e pranueshme. Nenin 42 shpjegon në mënyrë të detajuar pse është caktuar ky afat.

- **Neni nga Projektligji (i cituar)** – Neni 42 Miratimi i përfundimeve në lidhje me teknikën më të mirë në dispozicion

Paragrafi nga neni përkatës - (7) Pas skadimit të afatit nga paragrafi (6) i këtij neni, operatorit në afat prej katër vitesh i harmonizon kushtet e lejes në përputhje me kërkesat e reja të Konkluzioneve të GDT-së.

Koment - Periudha në të cilën industrinë duhet t'i harmonizojnë kushtet e lejes me konkluzionet e reja të NDT-së nuk duhet të jetë më e shkurtër se 8 vjet, sepse nuk justifikohet ekonomikisht të investohet në ndryshime të shpeshta (kapitale) në teknologji, sidomos për kushtet në të cilat funksionon ekonomia maqedonase, si dhe kriza botërore energjetike.

Përgjigje nga MMJPH-ja: Vërejtja nuk është e pranueshme. Kjo është e përcaktuar me DIREKTIVËN 2010/75/BE TË PARLAMENTIT DHE TË KËSHILLIT EVROPIAN nga 24 nëntori i vitit 2010 për emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes) (procesi i Seviljes).